



AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA UPOREĐIVANJE I VERIFIKACIJU IMOVINE
KOSOVO PROPERTY COMPARISON AND VERIFICATION AGENCY



Për verifikim të pronës private • Za verifikaciju privatne imovine • For private property verification

PLANI PËR INTEGRITET (2024 – 2026)

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Përgatitur nga grupi punues:

Gylshen Muharremi-Kryesuese e Njesisë për Administrimin e Pronave dhe Skemës së Qirasë.

Shqipe Rexhepi – Kryesuese e Zyrës Rajonale Prishtinë.

Bekim Krasniqi – UD. Kryesues i Njesisë për Zbatim.

26 Janar 2024

PËRMBATJA

Hyrja

Deklarata e Integritetit

1. QËLLIMI

2. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

2.1. Faza e parë

2.1.1. Formimi i Grupit dhe procesi i hartimit të planit të integritetit

2.2. Faza e dytë

2.2.1. Identifikimi dhe analizimi rreziqeve të integritetit

3. METODOLOGJIA

4. OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT

4.1. Implementimi i plotë i ligjit të AKKVP-së,

4.2. Rritja e transparencës në fushën e administratës në institucion

4.3. Rritja e transparencës në sistem të menaxhimit të burimeve njerëzore

4.4. Rritja e transparencës në fushën e prokurimit.

4.5. Përpunim efikas dhe transparent i gjithë dokumentacionit në të gjithë institucionin

4.6. Përmisimi dhe ngritja e transparencës në raport me marrëdhëniet me publikun

4.7. Auditimi i Brendshëm

5. PLANI I VEPRIMIT

6. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI

TABELA

Deklarata e Integritetit

Integriteti i një institucioni përbëhet nga parimet e rëndësishme të qeverisjes së mirë dhe është një nga treguesit e mirëfunksionimit. Mbrojtja dhe zbatimi i të drejtës pronësore private, përmirësimi i jetës së qytetarëve është një e drejtë themelore e njeriut e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Zbatimi i mandatit për Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahvim të Pronës është sfiduese po aq edhe e rëndësishme dhe për arritjen qëllimeve dhe e rezultateve të nivelit të lartë duhet mirë organizim i brendshëm, rritje të efikasitetit dhe paanshmëria, në mënyrë që forcimi i integritetit të jetë i pranishëm, prandaj Integriteti është instrumenti më i mirë për ndërtimin e institucionit të përgjegjshëm, transparente dhe llogaridhënës.

Vlerësimi i rreziqeve të integritetit për institucionin i cili mirret me çështje pronësore është e një rëndësie të veçantë, prandaj përpilimi i këtij plani të integritetit luan një rol kyç në promovimin e parimeve të transparencës dhe llogaridhënies së AKKVP-së.

Ne si institucion mundohemi në maksimum që të jemi shumë të ndërgjegjshëm për nivelin dhe situatën e korrupsionit dhe çështjeve të parregullta. Kjo tregon se duhet të jemi më vigjilent apo më të përgjegjshëm në menaxhim në mënyrë që llogaridhënia të jetë cilësore.

Plani do të kontribuojë në menaxhimin e riskut të integritetit të Agjencisë duke marrë në konsideratë masat konkrete për të trajtuar rreziqet e evidentuar në këtë plan.

Me këtë deklaratë, shprehim përkushtimin tonë ndaj vlerave të integritetit dhe bindjen tonë për ndërtimin dhe ruajtjen e një imazhi të lartë etik dhe profesionalizim për Agjencinë.

Kjo deklaratë është një shprehje e vullnetit tonë për të krijuar një mjedis të drejtë dhe transparent.

Aferdita Beka-Arifaj

Drejtoresh Ekzekutive

HYRJA

Në përputhje me nenin 25 të Ligjit nr. 08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe duke respektuar udhëzimet e "Metodologjisë së Planeve të Integritetit," të cilat detyrojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës-AKKVP ka hartuar dhe aprovuar Planin e Integritetit për periudhën 2024-2026. Ky dokument është një plan tre (3) vjeçar i brendshëm, i cili përditësohet çdo vit. Kjo procedurë e dokumentuar ka për qëllim vlerësimin e nivelit të rrezikut për integritetin brenda institucionit dhe ofron masa për menaxhimin e integritetit, me synim arritjen e objektivave të integritetit të institucionit.

Plani përforcon përkushtimin e AKKVP-së për shtimin dhe përmirësimin e kontrolleve operative në të gjitha aktivitetet brenda fushës së veprimtarisë së saj. Çështjet e integritetit dhe luftës kundër korrupsionit në Agjenci është një rëndësi e veçantë edhe në tërësinë e përpjekjeve dhe masave për përmbushjen e standardeve, e detyrimeve që ka institucioni në kuadër të përmbushjes së mandatit të paraparë me Ligj. Plani i Integritetit, i mbështetur në analizën e rreziqeve të lidhura me këtë aspekt në Agjenci, ka për qëllim identifikimin dhe vënien në funksion të mekanizmave për minimizimin e faktorëve që mund të lidhen me arsye, presione, raste apo mundësi të krijuara, e që shërbejnë si bazë për ekzistencën e korrupsionit, duke synuar në këtë mënyrë menaxhimin e rreziqeve dhe garantimin kurdoherë të shërbimeve cilësore, të paanshme e të përgjegjshme. Në këtë kontekst, ky dokument do të shërbejë si një mjet parandalues gjithëpërfshirës kundër korrupsionit, pasi synon promovimin dhe forcimin e integritetit duke përfshirë këtu integritetin individual, profesionalizimin, etikën, si dhe zbatimin e vlerave morale dhe standardeve profesionale.

Në vazhden e përpjekjeve për të konsoliduar institucionin dhe mbrojtjen e tij nga cënimi i integritetit, ky dokument synon të luajë një rol kyç për:

- Identifikimi, monitorimi, dhe zvogëlimi i rasteve të mundshme të korrupsionit në veprimtarinë e organizatës,
- Krijimi dhe promovimi i një kulture të integritetit brenda organizatës, duke përfshirë ndërgjegjësimin dhe trajnimin e personelit në vlerat dhe standardet etike.
- Rritja e transparencës dhe hapësirës së informacionit, duke siguruar që të dhënat dhe vendimet e organizatës janë të qasshme dhe të kuptueshme për publikun.
- Identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve të mundshme dhe parregullsive në fushat ku organizata mund të ekspozohet, duke zbatuar mekanizma të vazhdueshëm të monitorimit.
- Përmirësimi i marrëdhënieve me publikun dhe sigurimi i përgjegjshmërisë ndaj përdoruesve të shërbimeve dhe të interesuarve të organizatës.
- Ndërgjegjësimi dhe trajnimi i personelit për sfidat e integritetit, duke siguruar një kuptim të plotë të standardeve etike dhe ligjore.
- Identifikimi dhe menaxhimi i konflikteve të mundshme të interesit brenda organizatës, duke garantuar një trajtim të drejtë dhe të pavarur të çështjeve etike.
- Ndërtimi dhe ruajtja e një imazhi të fortë pozitiv të integritetit, që përforcon besimin dhe respektin në mes të organizatës dhe publikut

1. QËLLIMI

Forcimi i integritetit dhe kulturës organizative kundër korrupsionit, duke identifikuar rreziqet dhe duke planifikuar masat adekuatë të zbatimit brenda Agjencisë. Krijimi dhe implementimi i një sistemi efektiv për menaxhimin e integritetit brenda institucionit. Parandalimi dhe eliminimi i rrezikut nga korrupsioni dhe dukuritë tjera që cenojnë integritetin në Agjenci si dhe sigurojë se politikat, procedurat, mekanizmat e monitorimit të përshtatshme dhe funksionale.

2. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit i Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës –AKKVP është rezultat i një analize të kujdesshme të kryer përmes një kombinimi të pyetësorit, takimeve me fokus grupet, dhe analizave të kryera brenda institucionit. Fokusi kryesor i këtij vlerësimi ka qenë të identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve të mundshme dhe parregullsive në fushat ku AKKVP mund të ekspozohet. Për të arritur këtë qëllim, kemi ndjekur metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin për hartimin e Planeve të Integritetit, në përputhje me nenin 25 të Ligjit nr. 08/1-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit -APK.

Grupi i punues për hartimin e Planit të Integritetit është formuar nga personeli i vetë AKKVP-së. Kjo ka siguruar një përfshirje të drejtpërdrejtë dhe një kuptim të mirë të kontekstit institucional. Grupi i punues ka kryer një analizë të thelluar të rreziqeve të identifikuara, duke përfshirë vlerësimin e ndikimit të tyre dhe identifikimin e fushave më të prekura. Procesi i hartimit të planit ka përfshirë pjesëmarrjen e punonjësve të AKKVP-së dhe ka ndjekur hapat ku përmes pyetësorit, takimeve me fokus grupet, dhe analizave brenda institucionit, kemi identifikuar fushat potenciale ku integriteti i AKKVP-së mund të ndikohet nga rreziqe dhe parregullsi. Bazuar në identifikimin e rreziqeve, është krijuar një hapësirë e veprimeve që përfshin hapat konkrete për menaxhimin dhe zvogëlimin e rreziqeve të identifikuara.

2.1. Faza e parë:

2.1.1. Formimi i Grupit dhe procesi i hartimit të planit të integritetit

Duke u bazuar në kërkesën e Sekretarisë Ekzekutive për themelimin e një grupi punues për hartimin e Planit të Integritetit ku përbërja e tij do jetë prej tre(3) anëtarësh u formua me 15.11.2024 në krye me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimit të këtij plani. Pas konsolidimit të këtij grupi, fillimisht me 16.11.2024 u zhvillua një takim i përbashkët ku u njoh me metodologjinë dhe objektivat e vlerësimit të rrezikut të integritetit në institucionin tonë. Në këtë takim, përveç diskutimeve mbi konceptet kryesore, u shqyrtua dhe procesi që duhet të ndiqet për hartimin e Planit të Integritetit. Ky takim ofroi një bazë të fortë për grupin e punës për të adresuar disa nga çështjet dhe dinamikat kryesore të proceseve të punës në institucion. Gjithashtu në këtë takim u vendos që përkushtimi i grupit do jetë i plotë dhe aktiv, duke synuar sigurimin e një Plan të Integritetit të plotë dhe efikas për institucionin tonë. Ky grup do angazhohet për të kryer detyrën e tij me përgjegjësi dhe në mënyrë të përkushtuar për të kontribuar në zhvillimin dhe implementimin e një plani të integritetit që reflekton standardet më të larta të transparencës dhe integritetit.

2.2. Faza e dyte:

2.2.1. Identifikimi dhe analizimi rreziqeve të integritetit

Grupi i punues fillimisht shqyrtoi dokumentet ligjore, si rregulloret, dokumentet tjera të organizimit të funksionimit të punës në institucion. Gjithashtu analizoj raportet vjetore dhe propozimet e ndryshme ku janë bërë gjatë takimeve me 12 -15.12.2023 të ndryshme të zhvilluara ndërmjet grupit punues dhe punonjësve të ndryshëm në agjenci. Pas këtyre takimeve grupi i punës filloj rishqyrtimin e gjetjeve të këtyre dokumenteve duke bërë identifikimin dhe analizimin e rreziqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre në procesin e punës. Pjesë e kësaj analize ishin edhe të dhënat cilësore të mbledhura nga diskutimet në fokus grupe me punonjësit e agjencisë. Ku këto diskutime shërbyen për të identifikuar proceset e punës po ashtu edhe rreziqet e integritetit që mund të hasen si dhe u diskutua në lidhje me masat e ndryshme që mund të merren për të eliminuar apo trajtimin e rreziqeve. Në këtë fazë, grupi i punës analizoi të dhënat e përfituara edhe nga pyetësi për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit. Ky pyetësor është realizuar me punonjësit udhëheqës e Agjencisë gjate periudhes 20-24.11.2023 edhe përmes formatit elektronik. Përmes këtij pyetësi u siguruan edhe të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të integritetit ndër to edhe njohuri rreth çështjeve që kanë të bëjnë me etikën dhe integritetin në AKKVP.

3. METODOLOGJIA

Për hartimin e planit të integritetit si dhe për ta analizuar dhe vlerësuar integritetin në AKKVP, grupi i punës ka përdorur metodat e përzier si metoda sasore dhe metoda cilësore. Fillimisht është bërë një analizë në Agjenci për të parë nëse janë të parashikuara rregullat për etikën dhe integritetin. Më pas janë rishikuar dokumentet kryesore funksionimit të Agjencisë, si Baza ligjore, Rregullore të brendshme, Procedurat standarde operative, përshkrimet e punës, etj. Më pas u analizuan edhe të dhënat që u përfituan nga diskutimet në fokus grupe me stafin në Agjenci, diskutime që shërbyen për identifikimin e problematikave të hasura gjatë proceseve të ndryshme të punë të cilat kanë probabilitet të lartë për të pasur shkelje të integritetit apo sjellje jo-etike. Gjithashtu, për të matur perceptimin e stafit udhëheqës të AKKVP-së mbi çështje të etikës dhe integritetit u hartua një pyetësor, i cili iu vu në dispozicion të të gjithë stafi udhëheqës ku të gjithë nga ta iu përgjigjën këtij pyetësi. Shumica e stafit udhëheqës kanë përvojë mbi dhjetë (10) vite në institucion, dhe gjetet e këtij pyetësi tregojnë se për çështjet që lidhen me etikën dhe integritetin, stafi udhëheqës është i informuar çka edhe këtë e ka treguar edhe analiza e gjetjeve në takime me fokus grupe.

4. OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit i Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës -AKKVP synon të ndërmerr hapa konkrete për përmirësimin e kornizës etike dhe integritetit brenda institucionit. Qëllimi kryesor i këtij plani është të nxisë një kulturë të fortë të integritetit dhe të forcojë burimet njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin, ku qëllimi kryesor është krijimin e një mjedisi të punës plotësisht transparent e funksional.

Për të arritur këto; janë identifikuar shtatë (7) objektiva kryesore:

- Implementimi i ligjit i plotë i AKKVP-së,
- Rritja e transparencës në fushën e administratës në institucion.
- Rritja e transparencës në sistem të menaxhimit të burimeve njerëzore.
- Rritja e transparencës në fushën e prokurimit.
- Përpunim efikas dhe transparent i gjithë dokumentacionit në të gjithë institucionin.
- Përmisimi dhe ngritja e transparencës në raport me marrëdhëniet me publikun (MP/PR).
- Auditimi i Brendshëm

Këto objektiva janë thelbësore në krijimin e një mjedisi tërësisht transparent dhe të përkushtuar ndaj vlerave të etikës dhe integritetit në të gjitha nivelet e AKKVP-së.

4.1. Implementimi i plotë i ligjit të AKKVP-së,

AKKVP funksionon dhe operon në bazë të ligjit Ligjit 05/L-010 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në Nëntor të vitit 2016. Ky ligji ka vendosur strukturën dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, e cila ka për mandat të pranojë, krahasojë dhe të zgjidh zbrazëtit dhe mospërputhjet në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit të vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën e paluajtshme private

Përveç kësaj AKKVP në kuadër të këtij mandati, ka trashëguar edhe një pjesë nga mandati i AKP-së, kështu që me amendamentin e Ligjit duhet të filloj me ri-aktivizimin e administrimit të pronave si dhe skemën e qirasë.

Vlen të theksohet se Agjencia prej kohësh ka filluar aktivitete të ndryshme përgatitore, planifikimi dhe vlerësimi. Pra, hyrja në fuqi e ligjit Agjencinë e ka gjetur të përgatitur për fillim të zbatimit të mandatit të tij duke ndërmarr kështu shumë veprime si në drejtim të përgatitjeve për zbatim të mandatit të ri e gjithashtu edhe në përmbushjen e të gjitha obligimeve që dalin nga ligji i lartpërmendur. Disa nga këto veprime kanë përfunduar dhe disa janë ende në proces. Për të gjitha çështjet të cilat varen nga Agjencia, vlerësojmë se aktivitetet për procesin e tranzicionit janë duke u përmbushur siç është planifikuar.

4.2. Rritja e transparencës në fushën e administratës në institucion

Agjencia duhet përkushtuar në rritjen e transparencës në operimet e administratës, duke përfshirë një qasje të përgjegjshme dhe të hapur. Hapat dhe synimet që do të kishte nevojë të ndërmerren për të arritur transparencën në një nivel më të lartë është ndjekja dhe monitorimi elektronik i proceseve që rrjedhin nga funksionimi i administratës. Në veçanti përditësimi i të dhënave dhe trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të këtij sektori.

4.3. Rritja e transparencës në sistem të menaxhimit të burimeve njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore paraqet një nga proceset kryesore në funksionimin e çdo institucioni, edhe AKKVP- Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës ka dhënë një vëmendje të veçantë organizimit dhe përmirësimit të këtij procesi, si dhe forcimit të etikës dhe integritetit të punonjësve të saj.

AKKVP-së duhet të përfshij një rishikim të strukturës së pozitive të punës përmes funksionalizimit të organogramit të ri dhe ri-sistemimi të stafit ekzistues, dhe duke mbushur të gjitha pozitat vakante në institucion ku për gjithë këtë proces kërkohet transparence. Duke ndjekur një proces përzgjedhës transparent dhe të drejtë ri-sistemimi dhe plotësimi i pozitive vakante të kryhet në bazë të meritës, aftësive profesionale, personale dhe pa diskriminim. Nevoja për trajnime të stafit, qofshin ata të rinj apo me eksperiencë të gjatë në institucion, të evidentohet prioritet dhe ky proces të jetë transparent dhe i barabartë për të gjithë. Megjithatë, me synim të forcimit të integritetit dhe rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, AKKVP do ta zbatojë Ligjin për Zyrtarë Publik edhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme të parapara.

4.4. Rritja e transparencës në fushën e prokurimit.

Institucioni ynë është përkushtuar ndaj rritjes së transparencës edhe në fushën e prokurimit, duke ndërmarrë hapa konkrete që synojnë një proces më të hapur dhe transparent. Kemi një sistem për të krijuar një mjedis ku pjesëmarrësit dhe të interesuarit kanë një qasje të plotë dhe informacion të qartë rreth proceseve të prokurimit. Por, pavarësisht këtij sistemi kërkohet ngritje e transparencës në menaxhimin e të gjitha proceseve sidomos atyre në fushën e raport me operatorët ekonomik. Në theks të veçantë mungesa e një mekanizimi organizativ për menaxhimin e kontratave. Këto masa janë një shprehje e përkushtimit tonë për një prokurim më transparent, ku rritja e transparencës do të ndihmojë në rritjen e besimit dhe bashkëpunimit me pjesëmarrësit dhe publikut në përgjithësi.

4.5. Përpunim efikas dhe transparent i gjithë dokumentacionit në të gjithë institucionin

Procedimi, përpunimi dhe ruajtja e dokumentacionit dhe digjitalizimi i tyre përbën një nga objektivat kryesore të AKKVP-së, dhe kjo për faktin që AKKVP do mban dhe administron jo vetëm informacion me karakter pronësor apo informacion që përmban të dhëna personale, por administron dhe informacion që mundën me pas edhe karakter publik. Dokumentacioni i AKKVP-së mbahet jo vetëm në format hard copy (e printuar në letër) por dhe në format

elektronik. Të gjitha materialet të karakterit si; kërkesa, ankesa, shkresa të ndryshme, etj, shqyrtimi dhe administrimi i tyre dhe i të gjitha dosjeve që formohen nga AKKVP-së gjatë procesit të punës duhet të procedohen, trajtohen me transparence si nga aspekti ligjor po edhe ai rendor. Prandaj duke marrë parasysh natyrën dhe ndjeshmërinë e këtij procesi kërkohet ngritja e transparencës për një pasqyrë më cilësore.

4.6. Përmisimi dhe ngritja e transparencës në raport me marrëdhëniet me publikun

Përmisimi dhe rritja e transparencës në raport me marrëdhëniet me publikun është një detyrë thelbësore që shpërblehet me ndërtimin e besimit dhe krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme. Për të arritur këtë qëllim, është e domosdoshme të kemi një hapje të plotë të informacionit që ka rëndësi për publikun dhe vet institucionin tonë. Të gjitha ngjarjet, informatat, apo materiale të ndryshme që publikohen, dhe që janë në interes të publikut dhe institucionit, duhet të jenë të publikuara përmes mekanizmave në relacion me mosdhënien me publikun dhe gjithnjë duhet të jenë të azhurnuara me kohë reale.

4.7. Auditimi i Brendshëm

Mosplotësimi i pozitës së Auditorit të Brendshëm në institucion do të konsiderohej si një mungesë profesionale e cila mund të ndikojë negativisht në procesin e funksionimit të plotë dhe transparent të institucionit. Kjo situatë do të rrezikonte integritetin dhe performancën e brendshme të institucionit dhe mundësinë e shfaqjes së moskorrektësive dhe rritjes së rreziqeve të ndryshme. Për të ruajtur reputacionin dhe besueshmërinë e institucionit, është kritike të plotësohet kjo pozitë.

4.8. Njesia per Zbatim

Mos ekzekutimi i vendimeve në pjesën veriore të Mitrovicës cenon integritetin e institucionit dhe i një të drejte themelore të njeriut për riposedimin e pronës. Për përmbushjen e plotë të mandatit të AKKVP-së / Ekzekutimit të Vendimeve, na duhet bashkpunim i ngusht nga institucionet e vendit në veçanti institucioneve gjyqësore dhe atyre të sigurisë.

5. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit i Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës – AKKVP përfshin masat që duhet të ndërmerren nga institucioni për të adresuar rreziqet e evidentuara në fusha të ndryshme të veprimtarisë së AKKVP-së. Këto masa përfshijnë aktivitete të specifikuara, ku përcaktojnë strukturat përgjegjëse dhe afatin kohor për zbatimin e tyre. Plani i masave dhe aktiviteteve është i detajuar dhe specifik, me synim të plotësojë shtatë objektivat e identifikuara për forcimin e integritetit të punonjësve të AKKVP-së.

Me qëllim të reflektimit të praktikave më të mira, parashikohet mundësia e përmirësimit, ndryshimit apo përditësimit të planit të veprimit. Për të vlerësuar efikasitetin e masave të zbatuara, monitorimi do të identifikojë ndryshime në kontekstin institucional ose rreziqe të reja, që mund të sjellin nevojën për rishikim të planit. Për transparencë të plotë dhe informim të publikut plani i integritetit do të publikohen në faqen zyrtare të institucionit. Dhe kjo do të siguroj që procesi të jetë transparent dhe që publiku të informohet mbi zhvillimet relevante. Ky plan synon të krijojë mekanizma, praktika, kapacitete dhe aftësi të reja për AKKVP-në, në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe aktet nënligjore kundër korrupsionit.

6. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të organizatës. Ky plan ka për qëllim të përcaktojë dhe të promovojë një mjedis të drejtë dhe të ndershëm për të gjithë punonjësit. Struktura e Monitorimit dhe Zbatimit përfshin një strukturë të qartë dhe të përcaktuar për monitorimin dhe zbatimin e këtij Plani . Procesi i monitorimit do të përfshijë vlerësimin periodik të veprimeve të punonjësve dhe proceseve organizative për të siguruar respektimin e normave të integritetit. Ky vlerësim do të përfshijë identifikimin gjithashtu edhe trajtimin e çdo shkeljeje të integritetit. Zbatimi i Planit të Integritetit do të bëhet përmes përdorimit të mjeteve dhe burimeve të nevojshme për të siguruar përputhjen me legjislacionin.

Raportimi i rezultateve të monitorimit dhe zbatimit do të bëhet në mënyrë periodike çdo gjashtë (6) muaj dhe do të përfshijë një analizë të performancës. Përmes përcjelljes së rezultateve të monitorimit, do të identifikojmë fushat ku mund të ketë nevojë për përmirësime dhe do të ndërmarrim hapa konkrete për adresimin e tyre. Metodologjia jonë e monitorimit dhe zbatimit të Planit të Integritetit është një angazhim i vazhdueshëm për krijimin dhe mbajtjen e një mjedisi të drejtë dhe transparent.

Burime Njerëzore	Mos aprovimi i organogramit,	Baza Ligjore LIGJI NR. 08/L-197.	5	10	50	Aprovimi i Organo gramit të ri, riorganizimi dhe ri-sistematizimi i vendeve të punës dhe rekrutimi i stafit të ri komfor nevojave të institucionit.	MPB, Burimet Njerëzore.	12 muaj
	Mos rekrutimi i stafit profesional,							
	Mos Ri-sistematizimi i stafit.							
Prokurimi	Kontratat me operator ekonomik.	Baza Ligjore. Ligji Nr.05/ L-092	6	5	30	Parashtrimi dhe plotësimi i kërkesave komfor nevojave dhe të bazuara me akte ligjore.	Drejtori i Prokurimit	24 muaj
	Menaxhimi i kontratave					Krijimi i mekanizmit organizativ për menaxhimin e kontratave.		
Informimi	Mos informimi i plotë i audiencës rreth mandatit të AKKVP-së.	Procedura Standarde Operative e AKKVP-së për Informim	6	5	30	Dërgimi i mesazhit apo informatës tek audiencia përmes mjeteve të informimit dhe marketingut.	Zyrtari për Informim	12 muaj
Zyra e Auditorit të brendshëm	Mos plotësimi i pozitës së auditorit të brendshëm.	Baza ligjore. Ligji Nr. 03/L-128	5	10	50	Plotësimi i pozitës.	ZKA	12 muaj

Fushat e veçanta të rrezikut								
Identifikimi i rrezikut			Intesiteti rrezikut			Masat ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
Njësia e Procesimit të Kërkesave për njohje ligjore të pronës.	Trajtimi i barabartë, numerik rendor i kërkesave dhe procedimi i tyre.	Raportet e rregullta të procedimit të lëndëve.	8	9	72	Regjistrimi elektronik i rasteve për t'ju evituar parregullsitë.	Njësia për procesimit të kërkesave.	36 muaj
	Ankesat dhe Kërkesat							
Njësia për Zbatim	Mos ekzekutimi i vendimeve/ dëbimeve/ lirimi i pronave, veri të Mitrovicës.	Këthimi i posedimit të pronës	8	8	64	Ngritja e nivelit të baskupunimit me institucionet e gjyqësorit dhe sigurisë	Zyrtari për zbatim të vendimeve	36 muaj